



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 148, datë 28.08.2024

**PËR
MIRATIMIN E EMËRIMIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT
TË SHOQËRISË “RAIFFEISEN INVEST- SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE
TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të rregullores nr. 1, datë 31.01.2024 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e emërimit të zj. Juela Ahmeti, në pozicionin e anëtarit të Këshillit të Administrimit të shoqërisë “Raiffeisen Invest - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a., për një periudhë 3 vjeçare.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**